



Punime Hulumtuese



17 - 21 GUSHT 2015
OHËR, R.E MAQEDONSE

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

Përbajtja:

- Praktikimi i religjionit në rrëthimin multireligjioz, Rasti –

Republika e Maqedonisë pas pavarësisë dhe ndryshimit të

Kushtetutes
Grupi i punës 1: Daniel Josifovski, Petar Petkovski, Merisa Biberoviç, Ljupço Fillev, Naum Petkovski, Fisnik Jakupi, Marija A.

- #### ■ Shekullarizmi dbe religioni -

Rasti i Magedonisë

Grupi i punës 2: Ivana Tufegxhiq, Viktor Taleski, Aleksandar Milloshovski, Sabrije Kovaçi, Ilmije Zhaku, Stefan Jankovski, Nikolina Çorllinova

- Kuptime për multikulturalizmin në shoqërinë

maqedonase

Grupi i punës 3: Robert Stefanovski, Sadike Haxhiu, Simona Mladenovska, Sunai Sabrioski, Aleksandra Temeljkovska, Ivana Llazeska, Bobi Dilmov

- Perceptimi i implementimit të marrëveshjes kornizë të Ohrit

Grupi i punës 4: Jane Tërpkovski,
Gorjan Gérncharovski, Teuta
Xheladini, Biljana Janeva, Damjan
Serafimovski, Xhevit Dauti

- Roll i nacionalizmit ne trekëndëshin midis kombit, shtetit dhe religionit (Maqedonia)

Grupi i punës 5: Viktoria Taseva, Elena Mirçevska, Liridon Ceka, Ivica Cvetkovski, Toni Kuzmanovski, Katerina Jakimovska

Punimet Hulumtuese tē Shkollës Verore 2015



„Religjioni, Përkatësia Etnike dhe Nacionalizmi“

Hyrje:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Viti i dytë me radhë, Fondacioni Konrad Adenaur dhe Universiteti "Evro-Ballkan" – Shkup, e organizojnë shkollën verore me temë: "*Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi*", e cila kishte për qëllim të kontribuojë në tejkalimin e status kuos në lidhje me dallimet religjioze, nacionale dhe kulturore mes rinisë akademike në Republikën e Maqedonisë.

Shkolla verore pesëditeshe u mbajt në Ohër në periudhën prej 17 deri më 21 gusht të vitit 2015, dhe në të morën pjesë 33 të rind nga i gjithë shteti. Ata me këtë rast fituan mirëkuptim më të madh për atë se si religjioni, përkatësia etnike, nacionalizmi dhe identiteti kryejnë ndikim mbi shoqërinë dhe mbi individin. Në të njëjtën kohë, shkolla verore kontribuoi për rritjen e vetëdijes publike për rolin, rëndësinë dhe funksionin e profileve të ndryshme kulturore dhe religjioze në kushtet e realitetit shoqëror, ndërkulturor dhe demokratik në vendin tonë.

Përgjithësisht, tema e religionit nuk është adresuar në mënyrë të mjaftueshme në shoqërinë tonë, sidomos në mesin e të rindve. Shkolla verore shërbeu si platformë që çdo pjesëmarrës t'i rrit njohuritë e tij për religionet që janë të ndryshme nga religjioni i vetë, me çka u kontribua për demistifikimin e të panjohurës "tjetër" dhe u krijuar një bazë për kuptimin më të mirë për shoqërinë multietnike në të cilën jetojmë. Përmes ligjëratave të profesorëve eminent në shumë lëmi të ndryshme, diskutime, punëtori dhe vizita studimore, pjesëmarrësit e rind patën mundësinë për të eksploruar marrëdhënet mes shtetit dhe religionit, veçanërisht se si koncepti i multikulturalizmit funksionon dhe aplikohet në shoqëritë bashkëkohore. Theks i veçantë është dhënë në atë që aktivitetet e shkollës verore të mundësojnë përcjelljen e zhvillimit të ndryshimeve të paradigmave dhe teorive në dy dekadat e fundit në shoqërinë e Maqedonisë, por edhe në rajonin më të gjërë.

Puna e përkushtuar dhe aktive e pjesëmarrësve të kësaj shkolle verore, rezultoi me hartimin e punimeve në tema për të cilat ata shprehën interes të konsiderueshëm. Punimet janë dhënë në vazhdim të këtij botimi.

*Qëndrimet dhe konkluzionet e dhënë në punimet janë vetëm të autorëve
dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë qëndrimet dhe konkluzionet e or-
ganizatorëve të shkollës verore.*

Groupi i punës 1:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Daniel Josifovski
Petar Petkovski
Merisa Biberoviq
Ljupço Fillev
Naum Petkovski
Fisnik Jakupi
Marija Antova

**Praktikimi i religzionit në rrëthimin multireligjioz,
Rasti – Republika e Maqedonisë pas pavarësisë
dhe ndryshimit të kushtetitës**

1. Hyrje

Republika e Maqedonisë është shtet në territorin e të cilit, me gjenerata e gjenerata, ekzistojnë dhe funksionojnë religjione, kultura dhe etnikume të ndryshme. Zhvillimi historik i shtetit dhe popujve në këtë rajon njeh periudha kur religionet janë pranuar në mënyra të ndryshme nga ana e shoqërisë. Në periudha të caktuara, religioni ka qenë më fuqishëm i shprehur dhe i përfaqësuar në funksionimin e përditshëm të shoqërisë. Kanë ekzistuar ndryshime të shumta të religjioneve të ndryshme dhe edukata të ndryshme religjioze. Sot, në territorin e Republikës së Maqedonisë, praktikimi i religzionit midis popullatës kryhet përmes disa edukimeve religjioze. Në përputhje me të dhënrat e paraqitura gjatë regjistrimit në vitin 2002, përqindja më e madhe e popullatës, respektivisht 64,8% janë ortodoks, 33,3% mysliman, 0,35% katolik, 0,03% protestant dhe 1,5% janë pjesëtarë të bashkësive tjera religjioze dhe edukimeve religjioze.¹ Regjistri i Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë religjioze dhe grupet religjioze, përmbanë 35 kisha, bashkësi religjioze dhe grupe religjioze, prej të cilave si më të mëdha veçohen: Kisha

¹ Internet-burimi – Instituti shtetëror i statistikave të Republikës së Maqedonisë, Regjistrimi i popullsisë, amvisrive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë, 2002, të dhëna finale, f. 334-335 <http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf>, qasjer në muajin shtator të vitit 2015.

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Metodiste dhe Bashkësia Hebreje.²

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, përmes nenit 19, garantonohet liria e besimit fetar. Më tej, në nenin e njëjtë garantonohet shprehja e lirë dhe publike, individuale ose në bashkësi me të tjerë, e religionit. Në vazhdim të këtij nenit, teksti kushtetues thot se Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste-Metodiste dhe Bashkësia Hebreje, si dhe bashkësítë tjera religjioze dhe grupet religjioze, janë të lira në krijimin e shkollave religjioze dhe institucioneve sociale dhe humanitare në një procedurë të parashikuar me ligj.³ Me këtë nen vendoset shekullarizmi në funksionimin e Republikës së Maqedonisë.

Tema kryesore e këtij punimi është religjioni që do të shqyrtohet përmes **hipotezës kryesore të punimit**: *Praktikimi i religionit në Republikën e Maqedonisë e reflekton karakterin shekullarist të shtetit*, dhe **tri hipotezat ndihmëse**: (1) *Praktikimi i religioneve në shoqëri ka ndikim mbi politikat e shtetit*; (2) *Praktikimi i religioneve mundëson bashkëpunim midis religioneve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë*; (3) *Tek popullata në Republikën e Maqedonisë ekziston dëshirë për praktimin e religionit*. **Lëndë e hulumtimit** në procesin e konstatimit të saktësisë së hipotezave e përfshinë popullatën e moshës madhore në Republikën e Maqedonisë, nga të gjitha bashkësítë etnike, kulturore dhe religjioze.

Metodologjia e punimit i përfshinë metodat, teknikat dhe instrumentet që do të përdoren gjatë mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve për përpilimin e tij. Të kuptuarit e problematikës që e shqyrton ky punim bazohet në realizimin e një ankete në terren në lidhje me lëndën e hulumtimit, respektivisht popullatës të moshës madhore në Republikën e Maqedonisë, nga të gjitha bashkësítë etnike, kulturore dhe religjioze. Për më tepër, në bazë të të dhënave të mbledhura përmes anketimit është bërë një sistematizim me qëllim që të fitohen tregues statistikor, kurse është përdorur edhe metoda analitike-sintetike në drejtim të sigurimit të lidhshmërisë të shenjave të lëndës së hulumtar me dukuritë dhe proceset dhe të dhënat tjera të kuptuara përmes hulumtimit. Në procesin e hulumtimit të problematikës është bërë edhe përpunimi i burimeve të shkruara, studimi i akteve ligjore, veprave ekzistuese letrare dhe hulumtime tjera. Në këtë drejtim janë përdorur metoda dhe modele të analizës dhe sintezës të informacioneve të mbledhura statistikore

² Për më shumë shiko në: Komisioni për marrëdhënie me bashkësítë religjioze dhe grupet religjioze <http://www.kovz.gov.mk/>, qasje në muajin tetor të vitit 2015.

³ Internet-burimi – Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Kapitulli 1 – Dispozita të përgjithshme, neni 19 <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.npx>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonise

në lëmin e religionit. Përmes përdorimit të metodës komparative dhe historike është mundësuar një ndërhyrje më e detajuar në temën e punimit.

Nga aspekti shkencor dhe teorik, definimi i religionit si dukuri në bashkësitë shoqërore gjithmonë ka hasur në vështërsi. Vetë dukuria shoqërore, religjioni, në vete përmbanë shumë elemente që definimin e bëjnë pothuajse të pamundur. Autori i librit "*Religjioni si sistem kulturor*", Kliford Girc, e përshkruan religionin si sistem kulturor i cili në vete përmbanë një përbledhje besimesh dhe pikëpamjesh për krijimin e botës, jetës, njerëzimit dhe ekzistimit të saj. Në zhvillimin e njerëzimit kanë ekzistuar periudha kur religioni, përvèç si sistem kulturor, gjithashtu, ka qenë i involvuar pothuajse në të gjitha aspektet e funksionimit të shtetit dhe përfaqësonte rregullimin (sistemin) shtetëror. Nga ana tjetër, sot, shekullarizmi si parim i funksionimit të shtetit i veçon institucionet qeveritare (shtetërore) dhe personat e autorizuar që ta përfaqësojnë shtetin nga institucionet religjioze (fetare) dhe personave religjioz.

Të dhënët flasin se zgjerimi i krishterizmit në Maqedoni daton nga pjesa e dytë e shekullit të I-rë, rreth 60 vjet pas Krishtit, kur zhvillohet edhe udhëtimi ungjillor i Shën Pali Apostolit. Në shekullin e V-të në hapsirën e tërë territoriale të Maqedonisë ekzistonjë më shumë mitropoli dhe episkopi, prej të cilave më të njohura ishin Selaniku, Shkupi, Heraklea, Bargala dhe Stobi. Në atë periudhë edhe në tërë territorin e Maqedonisë ngriten shumë bazilika të hershme krishtere.⁴ Pastaj, Bashkësia Islame në Republikën e Maqedonisë ishte pjesë përbërëse e Bashkësisë Islame të Mbretërisë së Jugosllavisë, e më vonë të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Pas shpërbërjes së ish bashkësisë shtetërore dhe pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë, kjo bashkësi vazhdoi të veprojë si bashkësi e pavarur religjioze në Republikën e Maqedonisë, me seli në Shkup.⁵ Kisha Katolike në Maqedoni është themeluar në vitin 1918 kur është krijuar Mbretëria e Jugosllavisë, dhe kur një numër më i vogël i Maqedonasve kanë kaluar në katolicizëm. Eksarkia (Kryesia) e Kishës Katolike në Maqedoni është themeluar në vitin 1918, kur është krijuar Mbretëria e Jugosllavisë, dhe kur një numër më i vogël i Maqedonasve kanë kaluar në katolicizëm. Eksarkia është anuluar në vitin 1924. Pasi Jugosllavia është shpërbër, në vitin 2001

⁴ Internet-burimi: Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religjioze dhe grupet religjioze, <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=9B9239BFA0E1394295F1B8E9A51DAAAB>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

⁵ Internet-burimi: Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religjioze dhe grupet religjioze, <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=490D800DB5D9EF4FB7A6C2C269C523B0>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

Selia e Shenjtë sërisht emroi Eksarkin Apostolik në Maqedoni.⁶ Protestantizmi në Maqedoni ka filluar të depërtojë në gjysmën e dytë të shekullit 20. Mirëpo, përvèç asaj që sot nënkuqtohet me nocionin "protestanizëm", në këto hapsira në shekullin e 10-të ndodh diçka që është e njohur me një emër tjetër, për nga esenca e vetë është njëfarë lloji i protestantizmit. Bëhet fjalë për bogumilizmin. Në Republikën e Maqedonisë sot ekzistonjë më shumë bashkësi minoritare krishtere.⁷ Sot në Maqedoni jetojnë rreth 200 Hebrenj, mirëpo ekzistimi i Hebrenjëve në Maqedoni daton që nga shekulli i 6-të para epokës sonë. Hebrenjët kanë migruar në kohën e Periudhës Romake. Persekutimi ka detyruar që shumë Hebrenj të largohen nga vendet që ishin nën sundimin romak dhe një numër i vogël i Hebrenjëve zgjodhën Maqedoninë për shtëpinë e tyre.⁸

2. Hulumtimi në terren

Në drejtim të njohjes më të mirë të praktikimit të religjonit në Republikën e Maqedonisë dhe një ndërhyrje më e thellë në problematikën me të cilën merret ky punim, u realizua një hulumtim në terren. Hulumtimi që u realizua nga fundi i muajit gusht të vitit 2015, përbëhet nga një pyetësor anketimi me pesë pyetje të mbyllura.

Pyetja e parë është projektuar me qëllim që të kuptohet nëse praktikimi i religjioneve në shoqëri ka ndikim mbi politikat e shtetit, dhe kjo pyetje ishte si vijon: (1) A mendoni se religjioni duhet të përzihet në politikën? Në lidhje me këtë, pyetësori ka ofruar përgjigjet PO dhe JO: Të gjithë të anketuarit janë përgjigjur negativisht, respektivisht me JO. Kjo tregon se popullata është e vetëdijshme për atë se praktikimi i religjioneve në një shtet laik (shekullar) nuk duhet të ketë ndikim mbi politikat shtetërore.

Në pyetjen e dytë: (2) A mendoni se duhet të ekzistojë bashkëpunimi midis religjioneve të ndryshme?, që është shtruar me qëllim që të kuptohet nëse praktikimi i religjioneve mundëson bashkëpunimin midis religjioneve të ndryshme ne Republikën e Maqedonisë, 80% janë përgjigjur pozitivisht, respektivisht me PO, kurse 20% janë përgjigjur negativisht, respektivisht me JO. Kjo tregon

⁶ Internet-burimi: Komisioni për marrëdhënie me bashkësitetë religjioze dhe grupet religjioze; <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=B68C2394C64C894EAA04331655A47035>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

⁷ Internet-burimi: Komisioni për marrëdhënie me bashkësitetë religjioze dhe grupet religjioze, <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=BFF253DF95C8884785FFD6B65A39654E>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

⁸ Internet-burimi: Komisioni për marrëdhënie me bashkësitetë religjioze dhe grupet religjioze, <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=5A154BF8A697B644A05FAE389EA38DFD>, qasje në muajin shtator të vitit 2015.

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

se praktikimi i religjionit në Republikën e Maqedonisë duhet të mundësojë një nivel të lartë të bashkëpunimit midis religjioneve të ndryshme në shtetin tonë.

Tre pyetjet e fundit e shqyrtoton problematikën nga aspekti i asaj nëse tek popullata në Republikën e Maqedonisë ekziston dëshirë për praktikimin e religjionit. Pyetja e tretë ishte: (3) A mendoni se keni njojuri të mjaftueshme për religionin e juaj?, në të cilën përgjigje pozitive dhanë 70%, kurse përgjigje negative 30% nga të anketuarit. Në pyetjen e katërt (4): Nëse duhet rregullisht t'i viziton objektet religioze?, përgjigjet ishin të barabarta, respektivisht një gjysmë e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, kurse gjysma tjeter negativisht. Pyetja e fundit në pyetësorin anketues ishte: (5) Nëse doni që fëmija juaj të mësojë lëndën e Mësim-besimit ose Historinë e Religjioneve?, lëndën e Mësim-besimit e zgjodhën 20% të të anketuarve, kurse opzionin Historia e Religjioneve e zgjodhën 80% të anketuarve. Përgjigjet në këto tre pyetje tregojnë se dëshira për praktikimin e religjionit midis popullatës në Republikën e Maqedonisë ekziston tek një përqindje e pjesërishme e popullatës.

3. Përfundimi

Përfundimi kryesor, respektivisht konstatimi që del nga hulumtimi i realizuar flet për atë se në Republikën e Maqedonisë ekziston një vetëdije e zhvilluar se praktikimi i religjioneve është pothuajse në tërësi në përputhje me definicionin dhe karakteristikat e asaj që sot e quajmë shtet laik (shekullar). Pra, popullata tërësisht angazhohet dhe e mbështet funksionimin e politikës pa përzierje të religjionit. Pastaj, praktikimi i religjioneve në nivel kombëtar mundëson ndërëtimin e një sistemi ndër-religjioz të bashkëpunimit i cili funksionon paralelisht me sistemin shtetëror-politik dhe në përputhshmëri me sistemin ligjor të shtetit. Për më tepër, rezultatet e fituara gjatë këtij hulumtimi flasin për atë se tek pjesa më e madhe e popullatës ekziston dëshirë për praktikimin e religjionit.



Bibliografia:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Njësi të konsultuara bibliografike:

- Uiliam L. Rou – *Filosofia e religjionit – hyrje*, Arfs Lamina, Shkup, 2012.
- Dejvid Stjuart – *Studimi i filosofisë së religjionit*, Ars Lamina, Shkup, 2013.
- Eli M. Frejzer – *Temi në Filosofi dhe Religjionin*, Tabernakul, Shkup, 2010.
- Simeon A. Janakos – *Konflikti etnik-Religjioni, identiteti dhe politika*, Prosvetno Delo, Shkup, 2009.
- Geertz, Clifford, *Religion as a cultural system*. In: The interpretation of cultures: selected essays, Geertz, Clifford, pp.87-125. Fontana Press, 1993.

Internet-burime të konsultuara:

- <http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf> – Instituti shtetëror i statistikave të Republikës së Maqedonisë, *Regjistrimi i popullsisë, amvisrive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë*, 2002, të dhëna finale, f. 334-335, qasje në muajin shtator të vitit 2015,
- <http://www.kovz.gov.mk/> – Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religioze dhe grupet religioze, qasje në muajin tetor të vitit 2015.
- <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx> – Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Kapitulli 1 – Dispozita të përgjithshme, neni 19, qasje në muajin shtator të vitit 2015. <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=9B9239BFA0E1394295F1B8E9A51DAA> AB – Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religioze dhe grupet religioze, qasje në muajin tetor të vitit 2015.
- <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=490D800DB5D9EF4FB7A6C2C269C523> B0 – Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religioze dhe grupet religioze, qasje në muajin tetor të vitit 2015.
- <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=B68C2394C64C894EAA04331655A4703> 5 – Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religioze dhe grupet religioze, qasje në muajin tetor të vitit 2015.
- <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=BFF253DF95C8884785FFD6B65A39654> Е – Комисија за односи со верските заедници и религиозни групи, пристапено септември 2015 год.
- <http://www.kovz.gov.mk/?ItemID=5A154BF8A697B644A05FAE389EA38DF> D – Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë religioze dhe grupet religioze, qasje në muajin tetor të vitit 2015.

Groupi i punës 2:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Ivana Tufegxhiq
Viktor Taleski
Aleksandar Milloshovski
Sabrije Kovaçi
Ilmije Zhaku
Stefan Jankovski
Nikolija Çhorllinova

Shekullarizmi dhe religjioni Rasti i Maqedonisë

1. Hyrje

Historia është dëshmitare e cila tregon rolin të cilin fenomeni i religionit e ka luajtur në jetën e pothuajse çdo njeriu dhe globalisht në çdo shoqëri. Religioni është pjesë e rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të shteteve. Shtetet përmes akteve të tyre më të larta ligjore e rregullojnë pozitën e religionit, dhe në mënyrë indirekte edhe pozitën e institucioneve religioze. Varësisht nga zhvillimi historik i vendeve dhe kuptohet nga disa faktorë të tjera, ata zgjedhin nëse do të jenë shtete në të cilët vend të rëndësishëm do të kenë institucionet religioze dhe të njëjtat do të bashkëpunojnë me pushtetin duke i zgjidhur problemet e përbashkëta shtetërore ose, madje, në modelin e tyre do të mbisundojë koncepti i shekullarizmit, i cili bënë propagimin e ndarjes së shtetit nga religioni. Në një kuptim, shekullarizmi e lejon të drejtën e lirisë nga sundimi dhe të mësuarit religioz, si dhe të drejtën e lirisë nga imponimi i religionit ndaj qytetarëve nga ana e shtetit, që është neutral në lidhje me çështjet të ndërlidhura me religionin. Këto janë dy tema që janë objekt i hulumtimit tonë, duke e theksuar veçanërisht rastin e Maqedonisë në lidhje me këtë problematikë. Në faqet në vijim do të hulumtojmë kryesisht si Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e rregullon pozicionin e religionit? Nëse vendi ynë mund të shërbejë si shembull i shtetit shekullar? Nëse, megjithatë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë favorizon ndonjë bashkësie të caktuar religioze? Pastaj, pasojnë përgjigjet në këto pyetje përmes prezantimit të pjesës së

dytë që përbëhet nga hulumtimi në terren të cilin e zbatuan në suazat e kësaj tematike. Hulumtimi është realizuar me ndihmën e formës së pyetësorit me pesë pyetje.

2. Rregullimi kushtetues i religjionit dhe shkalla e shekullarizmit në Maqedoni

Rregullimi kushtetues dhe raporti i shtetit ndaj religjionit dhe grupeve religjioze në Republikën e Maqedonisë pas pavarësisë, mund të ndahet në dy periudha, në periudhën me miratimin e Kushtetutës të vitit 1991, dhe periudhën pas vitit 2001 dhe amandamenteve të miratuara që e prekin reportin e përmendur.

Sistemi i cili u vendos në periudhën e miratimit të Kushtetutës më 17.11.1991, e veçon Republikën e Maqedonisë si shtet civil dhe demokratik, në të cilin është vendosur koncepti i sundimit të ligjit dhe garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia kombëtare.¹ Në lidhje me çështjet të ndërlidhura me kufijtë e shekullarizmit, Republikën e Maqedonisë e veçon modeli i cili bazohet në tre postulate, si vijon:

- Së pari, standardec ndërkombëtare të Evropës Perendimore;
- Së dyti, traditat e popullatës shumicë të versionit ortodoks të krishterizmit, si dhe
- Së treti, realitetet e peisazhit aktual religjioz.

Problemet e modelit maqedonas të shekullarizmit, që do të dalin në sipërfaqe në periudhën e mëvonshme, shkojnë drejt sigurimit të ekuilibrit midis tre postulateve të përmendur mësipër.

Pas konfliktit ushtarak në Republikën e Maqedonisë në vitin 2001, janë miratuar amandamente nga ana e Kuvendit, e që dalin nga Marrëveshja e nënshkruar kornizë e Ohrit (MKO), erdhë deri tek ndryshime të caktuara në pozitën e bashkësive religjioze në jetën publike në shtetin tonë, edhe pse simbolike, megjithatë, për ata të rëndësishme.

Neni 19 i Kushtetutës, me të cilin përcaktohen kufijtë e shekullarizmit maqedonas, e veçon Kishën Ortodokse Maqedonase (KOM), kundrejt organizatave të tjera religjioze me formulimin: "KOM, si dhe komunitetet tjera dhe grupet religjioze". Me ndryshimet e vitit 2001, ky formulim me amandamentin VII ka ndryshuar, dhe tani është si vijon: "Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha Evangeliste-Metodiste,

¹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, Shkup, 1991, f.: 805-815.

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

11

Bashkësia Hebreite, dhe bashkësítë tjera religjioze dhe grupet religjioze".²

Religjionet konkrete janë ranguar në tre grupe, me ç'rast në grupin e parë hynë Kisha Ortodofokse Maqedonase (KOM), në grupin e dytë janë vendosur Bashkësia Fetare Islame (BFI), Kisha Katolike (KK), Kisha Evangeliste-Metodiste (KEM), Bashkësia Hebreite (BE), kurse në grupin e tretë të kategorizuara si "bashkësi tjera religjioze dhe grupe religjioze", janë vendosur religjionet tjera më të vogla. Në këtë drejtim, vendosja e organizatave religjioze në tre grupe nuk sjell me vete edhe vëllim të ndryshëm të drejtave dhe lirive që ata i realizojnë, por, kjo është më shumë në kuptimin historiko-shtetformues dhe simbolik përmes prizmës të karakterit të shtetit maqedonas, i cili në masë më të madhe bazohet në trashëgiminë e krishterizmit ortodox, kurse shtylla e kësaj doktrine religjioze është Kisha Ortodokse Maqedonase-Arkipeshkopja Maqedonase (KOM-AM).

Ajo që mund të shihet nga raportet midis politikës dhe religjionit në Republikën e Maqedonisë, është karakteri i modelit maqedonas të shekullarizmit, si dhe për raportin e partive politike në Republikën e Maqedonisë ndaj shekullarizmit, është një përshtypje se e politike e djathtë ka raporte më të afërtë me grupet religjioze në krahasim me politikën e majtë. Kjo në mënyrë figurative mund të shihet në praninë gjithnjë e më të shpeshtë të liderëve religjioz në ngjarjet publike, si dhe lobimi në marrëdhënet religjioze të bashkësive të caktuara religjioze në vendin tonë ose me bashkësítë religjioze jashtë shtetit tonë. Kurse, politika e majtë angazhohet për një ndarje më të madhe të shtetit nga bashkësítë religjioze, që nënkupton mospërzierje të institucioneve në punët religjioze, por edhe pamundësimi i bashkësive religjioze të përzihen në punën e institucioneve.

3. Hulumtimi në terren

Çdo njeri që nga lindja e tij, e ka në vete ndjenjën religjioze. Mirëpo, më vonë kjo ndjenjë varet se si kultivohet. Nëse e kultivon, njeriu vendos që të besoj në njërin prej religjioneve, respektivisht në atë për të cilin konsideron se është i saktë dhe i vërtet, por nëse e refuzon prej vetes këtë ndjenjë, ai bëhet ateist – njeri i cili nuk beson në Zot.

Për nevojat e tezës u realizua një hulumtim në terren në temën Religjioni, në të cilin u anketuan 28 qytetarë sipas përzgjedhjes së rastësishme. Prej këtyre 28 të anektuar, 21 ishin ortodoks, 5 mysliman, 1 hindu dhe 1 ateist. Kjo është e rëndësishme që të kihen

² <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.npx>

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

12

parasysh profilet e të anketuarve për pasqyrimin e mëtejshëm të përgjigjeve në pyetjet e shtruara.

Në pyetjen: sa shpesh e viziton tempullin religjioz, madje 17 personat e anketuar janë përgjigjur se shkojnë vetëm gjatë festave, 5 shkojnë shpesh (me termin shpesh nënkuftohet kohëpaskohe ose një herë në muaj), 5 janë përgjigjur se e vizitojnë tempullin religjioz shumë shpesh (një herë në javë), dhe një (1) asnjëherë.

Pastaj në pyetjen, që është temë qendrore e këtij punimi: nëse shteti është i ndarë nga religjioni; 14 të anketuarit janë përgjigjur se nuk është i ndarë, 6 janë përgjigjur se është i ndarë, dhe 8 persona të anketuar janë përgjigjur se nuk dijnë ose nuk u intereson.

Në lidhje me religionet tjera, situata është më pak ose më shumë pozitive: 27 të anketurit janë përgjigjur se raporti i tyre ndaj religjioneve tjera është pozitiv dhe tolerues, kurse vetëm një (1) është prëgjigjur se është i dhunshëm dhe jotalerues ndaj religjioneve tjera.

Si konfirmim në këtë pyetje pason edhe pyetja tjetër, respektivish, nëse do të vizitonin një tempull religjioz të një bashkësie tjetër religjoze, 25 të anketuarit janë përgjigjur se do ta vizitonin, kurse tre (3) se nuk do ta vizitonin.

Nga hulumtimi i realizuar mund të konkludohet se qytetarët nuk e shkojnë konceptin e shekullarizmit në Republikën e Maqedonisë ose nuk e njohin, më saktë, nuk dijnë se çka ai përfaqëson. Sëkëndejmi, është shumë me rëndësi që në Republikën e Maqedonisë të punohet jo vetëm në promovimin, por edhe në njohjen e qytetarëve me shekullarizmin, si një koncept i garantuar kushtetues.

4. Përfundim

Nga ajo që është theksuar më sipër, mund të përfundojmë se fokusi i këtij punimi hulumtues është vendos për shqyrtimin e problematikës që paraqitet midis shekullarizmit dhe religionit, në rastin konkret Maqedonia.

Shohim se formulimi "Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe bashkësitetë tjera religjoze dhe grupet religjoze" në Kushtetutën e vitit 1991, ka ndryshuar me amandamentet e vitit 2001, me të cilit është tejkaluar teza për favorizimin e Kishës Ortodokse Maqedonase kundrejt bashkësive tjera religjoze. Gjithashtu, kemi realizuar një hulumtim përmes personave anonim të anketuar me të vetmin qëllim, të kuptuarit e situatës reale, si shikohet në raportin midis religionit dhe pushtetit, respektivisht çfarë është përqindja e shekullarizmit në Republikën e Maqedonisë, nga i cili përfunduan se shumica e personave të anketuar konsiderojnë se shteti është i lidhur ngushtë me religionin. Duke e vendosur theksin në njëren ose

bashkësinë tjetër religjioze nga ana e udhëheqësisë politike të shtetit, në mënyrë të pashmangshme është imponuar problemi i paraqitjes të konflikteve religjioze dhe kombëtare. Mirëpo, nga analiza e jonë mund të vërejmë se ky problem është tekaluar me atë që ekziston një shkallë e madhe e tolerancës religjioze dhe kombëtare në mes të qytetarëve.

Siç është përmendur më sipër, duke e shikuar gjendjen aktuale në Maqedoni në lidhje me funksionimin e bashkësive religjioze dhe politikës, mund të vërehet se shteti nuk bënë një distinkcion të qartë midis politikës dhe religionit, që shihet prej pjesëmarrjes gjithnjë e më të shpeshtë të personave religjioz në ngjarje të rëndësishme politike dhe publike, por edhe bazohet mbi hulumtimin në të cilin qytetarët nuk e njohin ose nuk e kuptojnë konceptin e shekullarizmit.

Prej të gjithë kësaj del se për një funksionim më të mirë dhe më efikas të shtetit, është e domosdoshme të merren masa me të cilat do të respektohet shekullarizimi në një shtet, në këtë rast në Maqedoni, por edhe do të punohet në promovimin e ndarjes të shtetit nga religioni si koncept, me të vetmin qëllim – tekalimi i paraqitjes eventuale të intolerancës religjioze dhe kombëtare midis qytetarëve.

Mosrespektimi i shekullarizmit rezulton me një qëndrim negativ ndaj liderëve religjioz dhe liderëve politik nga ana e qytetarëve, që, madje, manifestohet përmes indifircës ndaj tempujve religjioz dhe liderëve religjioz dhe shkallës së rritur të mosbesimit në liderët religjioz, por edhe në liderët politik.

Bibliografia:

1. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, Shkup, 1991
2. <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx>
3. „*Procesi i deshekullarizimit të shoqërisë maqedonasehttp://www.newbalkanpolitics.org.mk/item/The-Process-of-Decentralization-in-Macedonian-Society/mk#.Vh4AMOyqqko)*
4. Villado Petrovski / Përbledhje vjetore 3-4 (2003/2004) „*RELIGJIONI SI FAKTOR I ARSIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISËhttp://eprints.udg.edu.mk/4346/1/%D0%A0%D0%95%D0%9B%D0%98%D0%93%D0%98%D0%88%D0%90%D0%A2%D0%90%D0%9A%D0%90%D0%9A%D0%9E%D0%A4%D0%90%D0%9A%D0%A2%D0%9E%D0%A0%D0%97%D0%90%D0%92%D0%90%D0%9D%D0%98%D0%95.pdf*
5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RM-së për shfuqizimin e lëndës – edukimi fetar në shkolla: Nr: 202/2008-0-1, data e miratimit: 04/15/2009
6. „Shekullarizmi dhe liria e besimit fetar“, Prof. Renata Treneska-Deskoska
7. W.Cole Durham, „*Perspektivat e lirisë religjioze: Korniza komparative në të drejtat religjioze të njeriut në perspektivën globale: Supozimet ligjore*“ (Johan D. Van and John Witte, JR.,eds), 1996
8. „*Homo religious midis religionit dhe shtetit*“, prof. d-r Gordana Siljanovska -Davkova.

Groupi i punës 3:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Robert Stefanovski
Sadike Haxhiu
Simona Mlladenovska
Sunai Sabrioski
Aleksandra Temellkovska
Ivana Llazeska
Bobi Dimov

Kuptimet për multikulturalizmin në shoqërinë maqedonase

1. Hyrje

Termi multikulturalizëm është një term kompleks dhe shumëdimensional. Rëndësia e tij ishte temë e një debati të madh midis qarqeve akademike edhe në diskursin politik perëndimor.³ Tema qendrore që përpunohet në të gjitha format e multikulturalizmit është identiteti individual dhe/ose kolektiv.

Sot sfidë e multikulturalizmit është të ndërtojë një sistem stabil i cili do t'i përfshijë dallimet etnike dhe kulturore, kurse një nga mënyrat më të shpeshta në të cilat këtë e bëjnë shtetet është mbrojtja e të drejtave civile dhe politike individuale.

Shikuar në tërësi, multikulturalizmi si koncept filozofik dhe politik paraqitet si zgjidhje, por edhe si problem. Nga njëra anë, ai është glorifikuar për përparimin e barazisë dhe kohezionit social të grupeve të ndryshme, kurse, nga ana tjeter, është kritikuar për krijimin e pabarazisë dhe se shpie deri te fragmentimi social.⁴

Nëse e vendosim konceptin e multikulturalizmit në kontekstin e të drejtave universale njerëzore (si përfitim universal i historisë njerëzore), para çdo shoqërie shtrohet dilema – nëse të pranohet parimi amerikan i të drejtave universale njerëzore, ku pavarësisht nga përkatësia etnike të gjithë gëzojnë të drejta të barabarta, ose parimi i

³ Në vitin 2010, kancelarja gjermane Angela Merkel, në fjalimin e saj para forumit rinor të Unionit kristian-demokratik, deklaroi se i ashtuquajturi koncepti "multi-kulti", ku njerëzit duhet të "jetojnë njëri pranë tjetrit" është projekt i dështuar.

<http://www.bbc.com/news/world-europe-11559451>

⁴ <http://www.theguardian.com/commentisfree/2010/mar/17/multiculturalism-diversity-political-policy>

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonise

ri specifik për shtetet evropiane, ku entitetave të veçanta minoritare u garantohen të drejta kolektive që kanë për qëllim ta përmirësojnë pozitën e minoritetave. Edhe pse ekzistojnë argumente *pro* dhe *contra* njërit dhe parimit tjetër, secili shtet duhet t'i proklamojë dhe garantojë të drejtat individuale njerëzore, por edhe t'i mbrojë interesat e minoritetave nga majorizimi.

Koncepti i multikulturalizmit drejtpërdrejti është i lidhur me gjenezën e paraqites të këtij fenomeni shoqëror. Në përgjithësi, koncepti i multikulturalizmit përfshinë forma të ndryshme të pluralizmit kulturor. Në zhvillimin historik shoqëritë njerëzore kanë forma të ndryshme për formimin e strukturës multikulturore: lëvizje nomade, pushtime koloniale, migracione vullnetare, lufta pushtuese, shpërngulje të dhunshme dhe arsyë të ndryshme, çdo shoqëri multikulturore ka histori të shfaqjes.

Pikërisht për shkak të rëndësisë së madhe dhe aktualitetit të kësaj çështjeje për shoqërinë maqedonase, në vendosëm që ta analizojmë nga aspekti i asaj se çfarë janë kuptimet për multikulturalizmin në shoqërinë maqedonase. Për këtë qëllim janë anketuar 11 persona të cilët kishin për detyrë të përgjigjen në disa pyetje (të elaboruar në mënyrë të detajuar në tekstin e mëtejmë). Metodologja që është përdorur është anketë pjesërisht e standardizuar me pyetje të hapura, që do të thotë se personave të anketuar u janë ofruar pyetje, kurse ata vetë i kanë përgatitur përgjigjet.

2. Çfarë janë kuptimet për multikulturalizmin në shoqërinë maqedonase?

Me qëllim që të shihet çfarë është qëndrimi i njerëzve për multikulturalizmin, të mësohen pikëpamjet e tyre për të njëtin, dhe të fitohen rezultate, anketa tregoi si vijon:

1. Çfarë është multikulturalizmi?


Numri më i madh i të anketuarve (7 persona) u përgjigjen se me nocionin multikulturalizëm nënkuqtojnë më shumë popuj që jetojnë në një shtet, dy të anketuar thanë se ky nocion do të thotë pranim i llojlojshmërive, kurse dy të anketuar nuk kishin koment në këtë pyetje.



**SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALISMI"**

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë


16



2. A mendoni se Maqedonia është vend multikulturor?

Nga pyetja e dytë i morëm këto përgjigje:

- tetë prej të anketuarve mendojnë se Maqedonia është shtet multikulturor;
- dy prej të anketuarve mendojnë se Maqedonia pjesërisht është vend multikulturor;
- një prej të anketuarve tha se Maqedonia nuk është vend multikulturor.



3. Në cilat pjesë të Maqedonisë mendoni se më së shumti është i përfaqësuar multikulturalizmi?


Mund të thuhet se në këtë pyetje të anketuarit kishin më shumë se një përgjigje. Shumica prej të anketuarve konsiderojnë se në Shkup më së shumti është i përfaqësuar multiukulturalizmi, pastaj në Manastir, Ohër, Kumanovë, etj.



SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALISMI"


17

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë




4. Sa ndikon multikulturalizmi në zhvillimin e një vendi?

Gjashtë prej të anketuarve janë përgjigjur se multikulturalizmi ndikon në zhvillimin e një vendi, kurse nga një prej të anketuarve janë përgjigjur se ndikon pjesërisht ose nuk ndikon aspak.



5. Në cilin vend mendoni se multikulturalizmi është më së shumti i përfaqësuar?

Mund të thuhet se në këtë pyetje të anketuarit kishin më shumë se një përgjigje, kurse shumica e të anketuarve thanë se në Amerikë multikulturalizmi është më së shumti i përfaqësuar.





3. Përfundimi

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Tema qendrore që përpunohet në këtë punim janë të gjitha format e multikulturalizmit dhe identiteti individual dhe/ose kolektiv. Në vendosëm që ta analizojmë nga aspekti se çfarë janë kuptimet për multikulturalizmin në shoqërinë maqedonase.

Për të pasur një pasqyrë më të plotë për atë se cilat janë kuptimet për multikulturalizmin në Maqedoni, në realizuam një anketë në terren, anketë kjo në të cilën morëm përgjigje të cilat pastaj i elaboruam dhe arritëm deri tek këto përgjigje:

- në Maqedoni me nacionin multikulturalizëm shumica u përgjigjën se nënkuptojnë më shumë popuj që jetojnë në një shtet;
- njerëzit në Maqedoni konsiderojnë se Maqedonia është shtet multikulturor;
- shumica konsiderojnë se Shkupi është qyteti në të cilin më së shumti është i përfaqësuar multikulturalizmi;
- të anketuarit konsiderojnë se multikulturalizmi ndikon në zhvillimin e një vendi, dhe
- shumica e të anketuarve konsiderojnë se multikulturalizmi më së shumti është i përfaqësuar në Amerikë.

Bibliografia

1. *Merkel says German multicultural society has failed*
<http://www.bbc.com/news/world-europe-11559451>
2. „*British prime minister: Multiculturalism has failed*“, NCBNEWS,
2.06.2011, http://www.nbcnews.com/id/41444364/ns/world_news-europe/t/british-pm-multiculturalism-has-failed/#.VCsjzZSSzOB

Groupi i punës 4:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Jane Tërpkovski
Gorjan Gërnçarovski
Teuta Xheladini
Biljana Janeva
Damjan Serafimovski
Xhevit Dauti

Perceptimi i implementimit të marrëveshjes kornizë të Ohrit

1. Vështrimi historiografik dhe teza paradigmatike

Konkretnisht, në diskutimet për imlementimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit (në tekstu Marrëveshja), analistikët e theksojnë integrimin politik me variantin socio-kulturor dhe variantin e shpërndarjes së fuqisë politike (Atanasov, 2003: 115-42). Respektivisht, tezë bazike është teoria e *Glazer* dhe e *Moynihan* për instrumentalizimin dhe mobilizimin. Përveç kësaj, intensiteti i solidaritetit kolektiv forcohet me ndërtmjetësimin e tri elementeve që i integrojnë, kurse janë vendimtare gjatë formimit të shtetit kombëtar dhe përcaktimit të statusit civil: origjinë, gjuhë dhe religion të njëjtë kombëtar (Putinja; Stref-Fenar. 1997: 107-8. Haralambos, Holborn, 2002).

Në rastin e Republikës së Maqedonisë, me ndryshimet tranzicionale pas rënies së Jugosllavisë së katërt, përveç reformave në fushën e makro-ekonomisë dhe në fushën e sistemit politik-ligjor, shoqëria u ballafaqua me eskalimin e konfliktit ndëretnik.

Rrethanat kryesore janë:

- Vala e emigracionit, e cila ndikon në rritjen e popullsisë shqiptare në strukturën e përgjithshme;

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

- Mobilizimi etno-politik me përshkallëzimin e eskalimin të konfliktit ndërmjet formacioneve paramilitare shqiptare dhe strukturave maqedonase politike e të sigurisë;
- Kërkesat e liderëve politikë shqiptarë, të cilat përfshijnë si vijon:
 1. Maqedonia të mos jetë më etnocentrike, siç parashikohet me Kushtetutën e vitit 1991;
 2. inkluziviteti më i madh edhe atë konform standardeve dhe konventave ndërkombëtare për të pasqyruar realitetin multikulturor;
 3. përfaqësimi i identiteteve minoritare etnokulturore, të Shqiptarëve në Maqedoni, në institucionet shtetërore;
 4. buxheti më i lartë dhe për autorizime më të mëdha të bashkësive lokale ku shumica janë Shqiptarë edhe atë kryesisht për socialen, shëndetësinë dhe arsimin;
 5. miratimi i një ligji të veçantë dhe special për amnistit (Atanasov. *Ibidem*).

Të dhëna kryesore për Marrëveshjen kornizë të Ohrit

- Paraqet një dokument ligjor nënshkruar më 13 gusht të vitit 2001, në Ohër, nga ana e preasidentit të Republikës së Maqedonisë, kryetarëve të partive VMRO-DPMNE, LSDM, PDSH, PPD, dhe me ndërtmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare.
- Paraqet një mekanizëm unik ligjor i cili obligon zgjidhjen e konfliktit ndëretnik dhe garanton perspektivë të suksesshme eurointegruese.
- Përmban kërkesa të bashkësisë etnike shqiptare:
 1. refuzimi i dhunës për qëllime politike
 2. thirrje në sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Republikës së Maqedonisë (nuk ka zgjidhje territoriale për çështje etnike)
 3. karakteri multietnik pasqyruar në jetën publike të shoqërisë maqedonase
 4. Kushtetuta konform standardeve ndërkombëtare t'i respektojë nevojat e të gjithë qytetarëve
 5. zhvillimi i vetëqeverisjes lokale për të respektuar identitetin e bashkësive
- Sjell ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë nga 17 nëntori i vitit 1991.

Ekspertët e evalvimit arrijnë konsenzus se Marrëveshja kontribuoi që disa dispozita të synojnë drejt modelit të shtetit binacional, por i zgjidhi konfliktet ndëretnike. Në këtë mënyrë, duke i ndjekur dispozitat, sot shoqëria maqedonase është multikulturore me një model të kohezionit social dhe elemente të pluralizmit liberal

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

dhe korporativ. Për më tepër, konfirmohet supozimi se Republika e Maqedonisë mund, dëshiron dhe dinë që në mënyrë politike dhe civile ta realizojë përbajtjen e vetë multikulturore, sepse paraqet përgjigje në të gjitha pyetjet. Në këtë drejtim, sipas vlerësimeve të faktorit ndërkombëtar, Marrëveshja është kornizë për sigurimin e ardhmërisë së demokracisë në Republikën e Maqedonisë dhe për mundësimin e zhvillimit të proceseve eurointegrative (Atanasov. *Ibidem.*) (Çupeska. 2013: 119–34).

2. Metodologja me analizë descriptive statistikorve

Qëndrimi hipotetik	Marrëveshja e nënshkruar Kornizë – Ohër, 2001, pas pesëmbëdhjetë viteve të para, suksesshëm po implementohet në praktikën ditore të dialogut ndëretnik.																													
Mostër	Një mostër e rastësishme prej 10 respondentëve, pavarësisht karakteristikave demografike.																													
Metoda	Anketë deduktive, në nivel ordinar, me shkallën e Likertit me kategori ekskluzive në tre nivele.																													
Indikatorë	<ul style="list-style-type: none"> • tejkalimin i diskriminimit në sferën publike; • arritje e barazisë dhe respektit në lidhje me dallimet; • sipas etnicitetit, në komunat, u mundësua punësimi i barabartë; • arritje e ndërprerjes së intolerancës në komunikimin midis grupeve etnike; • arritje e suksesshmërisë në nivel ndërkombëtar si një Akt i besimit dhe stabilitetit. 																													
Kros-analizë e frekuencës procentuale	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th></th> <th colspan="2">arriti tejkalimin e diskriminimit në sferën publike</th> <th colspan="2">arriti respektimin e diversitetit dhe barazisë</th> <th colspan="2">sipas etnicitetit, në komunat, mundësoli punësimi të barabarta</th> <th rowspan="3" style="vertical-align: middle;">arriti ndërprenjen e intolerancës në komunikimin ndëretnik si një akt ndërkombëtar, arriti një implementim të sukseshëm në RM</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>nuk pajtohet</td> <td>30</td> <td>20</td> <td>10</td> <td>50</td> <td>30</td> <td></td> </tr> <tr> <td>pajtohet</td> <td>20</td> <td>30</td> <td>70</td> <td>20</td> <td>70</td> <td></td> </tr> <tr> <td>pjesërisht pajtohet</td> <td>50</td> <td>50</td> <td>20</td> <td>30</td> <td>0</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		arriti tejkalimin e diskriminimit në sferën publike		arriti respektimin e diversitetit dhe barazisë		sipas etnicitetit, në komunat, mundësoli punësimi të barabarta		arriti ndërprenjen e intolerancës në komunikimin ndëretnik si një akt ndërkombëtar, arriti një implementim të sukseshëm në RM	nuk pajtohet	30	20	10	50	30		pajtohet	20	30	70	20	70		pjesërisht pajtohet	50	50	20	30	0	
	arriti tejkalimin e diskriminimit në sferën publike		arriti respektimin e diversitetit dhe barazisë		sipas etnicitetit, në komunat, mundësoli punësimi të barabarta		arriti ndërprenjen e intolerancës në komunikimin ndëretnik si një akt ndërkombëtar, arriti një implementim të sukseshëm në RM																							
nuk pajtohet	30	20	10	50	30																									
pajtohet	20	30	70	20	70																									
pjesërisht pajtohet	50	50	20	30	0																									
Rezultate dhe rekomandime	<p>Nga pozicioni metodologjik, kriteret për nivelin e besimit në përgjigjet janë plotësuar përmes përputhjes logjike procentuale të përgjigjeve tek kros-pyjet. Ky është treguesi për vlefshmërinë e instrumentit për anketimin e opinionit publik.</p> <p>1) Në nivel të përgjithshëm, qëndrimi i qytetarëve është proporcional me tezat e veçanta të qëndrimit hipotetik. Numrat flasin se përafersisht, ky është rasti me shpatë nga dhjetë prej të anketuarve. Por, në mungesë të egzogeneve dhe varijablave intervente (karakteristika demografike), intepretimi është reduktuar në një nivel nominal.</p> <p>2) Në nivel individual, numrat flasin se përafersisht, tetë nga dhjetë prej të anketuarve pajtohen me qëndrimet kryesore (lidhur me respektimin dhe realizimin e kërkesave kryesore, por edhe me konsekuençën e dokumentit ligjor, si një lloj akti ndërkombëtar).</p> <p>Për shkak të përqindjes relativisht të lartë të mohimit të tezës në lidhje me komunikimin ndëretnik mbi baza ditore, si dhe për shkak të manifestimit relativisht të shpeshtë të skepticizmit në lidhje me tezën për tejkalimin e diskriminimit në sferën publike, imponohet nevoja e theksimit të rëndësishës të masave të politikës kulturore, respektivisht, mediumeve informative, si mekanizëm për krijimin e opinionit publik, që orientojnë drejt promovimit të dialogut ndërkulturore.</p>																													




3. Rezime

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Nga pozita strukturore, punimi bazohet në dy nivele – interpretimin teorik dhe analizën e aplikuar. Në kontekstin epistemologjik, që është objekt i hulumtimit, është me karakter interdisiplinar, me një domen në fushën e nacionalizmit. Nga aspekti metodologjik, projektii bazohet në dy nivele – kontekstin historiografik të rrethanave shoqërore dhe analizën empirike të opinionit publik të qytetarëve.

Studimi bazohet në operacionalizimin e elementeve të tezës për instrumentalizimin dhe mobilizimin në Teoritë bashkëkohore për etnicitetin, me ç'rast në nivelin empirik u arritën këto rezultet:



Prezantimi grafik 1. „Frekuencia e përqindjeve të përgjigjeve nga anketa“

Parametrat për vlerësimin e nivelit të implementimit të suk-sesshëm janë zgjedhje e drejtpërdrejt nga *Content Analysis* e segmenteve kryesore të Marrëveshjes. Respektivisht, varijablat janë në të gjitha nivelet, të tanguara në lidhje me Marrëveshjen. Rezultatet dhe rekondimet bazohen në:

- arsenalin e rrethanave shoqërore;
- analizën e përbajtjes së Marrëveshjes;
- interpretimin e vlerësimeve të ekspertëve eminent;
- interpretimin e qëndrimeve të qytetarëve.

Në përgjithësi, qytetarët e intervistuar u pajtuan se **në praktikë Marrëveshja është implementuar me sukses**, në të gjitha nivelet, kështu që duke gjykuar sipas *Prezantimit grafik 1*, për variabla të



**SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALISMI"**

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

23

ndryshme, qëndrimi hipotetik po konfirmohet, por për shkak të varijacioneve të cilat nuk janë të rastësishme, por janë të bazuara logjikisht, rekomandimet janë fokusuar në politikën kulturore, respektivisht, në **nevojën e promovimit të dialogut ndërkulturor**, kurse përmes mbështetjes institucionale të mediumeve.

Bibliografia:

1. Atanasov, Petar. *Multikulturalizmi si teori, politikë dhe praktikë*. Shkup: Euro-Balkan Press, 2003.
2. Kimlika, Ull. *Qytetaria multikulturore*. Shkup: Institut i demokracisë, solidaritetit dhe shoqërisë civile.
3. MARRËVESHJA KORNIZË E OHRIT.
4. KUSHTETUTA e Republikës së Maqedonisë: me amendamentet e Kushtetutës I – XXX. Shkup: Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, 2007.
5. Çupeska, Ana. *Identitetet kulturore në politikë: apektet e multikulturalizmit*. Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer, 2013.
6. Haralambos, Michael; Martin Holborn. *Sociologjia: temat dhe perspekativat*. Zagreb: Golden marketing, 2002.
7. Putinja, Filip; Zhoslif Stref–Fenar. *Teoritë për etnicitetin: (Shtojcë: F. Bart. Grupet etnike dhe kufijtë e tyre)*. Beograd: Biblioteka Shekulli XX, 1997.



17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

Groupi i punës 5:

Victoria Taseva
Elena Mirçevska
Liridon Ceka
Ivica Cvetkovski
Toni Kuzmanovski
Katerina Jakimovska

Roli i nacionalizmit në trekëndëshin midis kombit, shtetit dhe religionit (Maqedonia)

1. Hyrje

Njeriu në komponentën e tij bio-sociologjike është zon-politikon, kriesë politike që përpinqet të identifikohet me grupin, bashkësinë ose idenë. Ka më shumë baza për identifikim në të cilat njeru në të njëjtën kohë mund të mbështetet në ekzistencën e vetë, prandaj njerëzit gravitojnë rreth komponentës unifikuese – religionit, etnicitetit, kombit, kulturës, etj. Në kuptimin historik, kombi si konkretësi paraqitet pas Revolucionit francez, kur Napoleoni e braktis rregullimin tradicional shtetëror dhe implementon një sistem të ri të qeverisjes, ku individin e vendos në një pozitë të barabartë, që ndosha ishte faktori kryesor për krijimin e kombeve bashkëkohore.¹ Me revolucionin në Francë, kombi e legjitimoni shtetin dhe me këtë shteti kombëtar, si krijim i krijuar me një konsenzus shoqëror, e mbështet mbi popullin.

Teoricienë dhe historianë të ndryshëm jepin mendime të ndryshme për kombet, për formimin dhe ekzistimin e tyre, por të gjithë pajtohen se kombet bashkëkohore janë fenomene që mund në mënyra të ndryshme të definohen, kurse njëri prej definicioneve të shumtë është: *njerëz me një të kaluar të përbashkët, religion, gjuhë, kulturë, që jetojnë në një teritor dhe që janë të ndërlidhur me relacione të përditshme, paraqet komb.*² Kombet bashkëkohore gjithmonë krijohen prej shtetit edhe pse ka ndonjë përjashtim kur

¹ Popov Çedomir, Evropa Civile (1770-1914) Historia politike e Evropës (1815-1871) Beograd 2010.

² Aćkoska Violeta, Leksione nga shteti bashkëkohorë maqedonas (1944-1990) Shkup 2011. (shiko mëshumë në shtojcën 4, Nocionet, f. 478-490)

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

kombe të caktuara formohen pa shtet në të cilin do të kishin personifikim, për shembull: Kurdët dhe Romët. Nacionalizmi si koncept paraqitet pothuajse në të njëjtën kohë me paraqitjen e kombeve dhe paraqet një ide sipas së cilës pjestarët e një kombi e lartësojnë kombin e vetë në një kult më të lartë ndaj kombeve tjera fqinje.

Element i rëndësishëm për kombet dhe nacionalizmin është shteti, ai është njëfarë nxitësi, frenuesi ose mirëmbajtësi i këtyre dukurive, ai e formon kombin ose atë bashkësi abstrakte të njerëzve që mund të jenë njerëz me religion të njëjtë (për shembull: Grekët), ose një rajon gjuhësor (për shembull: Francezët), ose ndikim kulturor (për shembull: Rusia). Politikat shtetërore ndaj kombeve, por edhe interesat e tyre strategjike i detyrojnë shtetet të bëjnë përpjekje në periudha të caktuara kohore që ta forcojnë fryshtat kombëtare, ose ta nxisin nacionalizmin tek qytetarët e vetë, varësisht nga rrëthanat politike.³ Por, ka edhe raste kur shteti kryen asimilimin kombëtar ndaj një grupei të caktuar njerëzish për qëllime ose interesa më të larta shtetërore.⁴

Në lidhje me religionin, ai ka rolin qendoror në formimin e identiteteve të shumë shteteve evropiane (Greqia, Polonia, Irlanda, Anglia, etj). Ajo që është e përbashkët për kombin, religionin dhe shtetin, është që jep përgjigje në pyetjen: **kush jam unë dhe ku është vendi im në shoqëri?** Identiteti religjioz i paraprinë identitetit kolektiv kombëtar. Në mesjetë, identifikimi primar i individit ishte religjioz.⁵ Në fillimin e shekullit 18, shteti bëhet bashkuesi i identitetit religjioz dhe kombëtar. Njeriu mund t'i takojë një religioni ose kombi të caktuar dhe të jetë pjesë e shtetit që kultivon vlera të caktuara kobëtare si vlera parësore.

Republika e Maqedonisë kultivon një model autentik të sekularizmit, diku midis modelite të religionit shtetëror dhe sekularizmit për shkak të ndarjes të Kishës Ortodokse Maqedonase kundrejt organizatave tjera fetare, por në grupin themelor të të drejtave dhe garancive për lirinë e religionit, respektohen standartet të shteteve të zhvilluara demokratike.⁶

³ Scott, Len, International History, 1900-90, Oxford University Press, 2008, pg

⁴ Zoran Janjetović. Fëmijët e perandorëve, pastorë të mbretërve, Minoritet nationale në Jugosllavi (1918-1945) Beograd 2005.

Sipas autorit, tendencia për formimin e kombit jugosllav është një ambicje e mbretit Aleksandar që ta forcojë pushtetin në shtet, por deri te kjo nuk erdhë për shkak të një arsyese të kuptueshme mbasi tanë më ishte e formuar dhe të doktrinizuar vetëdija kombëtare serbe, kroate dhe sllovene.

⁵ Bakraç Vladimir "Qasje teorike ndaj ngjashmërive dhe dallimeve midis religionit dhe kombit", Religjioni dhe toleranca, Vol. VII, № 12, Korrik-Dhjetor, 2009 f. 337

⁶ D-r Spasenovski Aleksandar, Ndikim i bashkësive religjioze në institucionet dhe politikën e RM-së, Fondacioni Konrad Adenauer, Shkup, shkurt 2015, f. 7

17 - 21 Gusht, 2015
Ohër, R. E Maqedonisë

Duke përdorur metodën analitike dhe rezultatet e mini-hulumtimit të shkollës verore "Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi", ky punim ka për qëllim theksimin e rolit përqarës të nacionalizmit në raportin trepalësh midis kombit, shtetit dhe religionit.

2. Nacionalizmi në kontekst të shoqerisë bashkëkohore maqedonase

Mini-hulumtimi që e zbatoi grupi i pestë i shkollës verore "Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi", konfirmoi disa prej tezave fillestare të grupeve. Në hulumtimin tonë të nacionalizmit, të gjithë të anketuarit shikonin si në një dukuri negative, edhe pse nuk arritën të japid një definicion konkret për atë çka është nacionalizmi. Në deklaratat e tyre u tregua se ende ekziston mosbesimi midis bashkësive. Tek përfaqësuesit e Maqedonasve etnik, ekzistojnë qëndrime se *disa karakteristika kombëtare ndikojnë mbi sjelljen e individëve*, që u konfirmua në bisedimet me një pjesë të të anketuarve në hulumtimin tonë. Qëndrimi i përgjithshëm i të anketuarve (rreth 75%) ishte pozitiv në lidhje me bashkëjetesën, por me një përqindje të njëjtë qytetarët janë unanimisht kundër martesave të përziera etnike. Në lidhje me pyetjen *nëse nationalisti lind ose bëhet*, dy të tretat e të anketuarve u pajtuan se nationalisti bëhet.

Rezultatet e hulumtimit treguan një ndikim të fuqishëm në disa karakteristika të caktuara kombëtare dhe religjioze mbi sjelljen e individëve në dy bashkësitë më të mëdha etnike. Në lidhje me shtetin, bashkësia më e madhe minoritare në një masë më të vogël tregon përkatësinë ndaj shtetit Republika e Maqedonisë në krahasim me të tjerat, që mund të paraqet një indikator për formën e nacionalizmit, mbasi refuzon të identifikohet me shtetin në të cilin jeton.

Pikërisht kjo qëndron edhe në tezën e Kuperit se refuzimi të pranohet karakteri multietnik i shtetit nga ana e bashkësisë shumicë sjell deri tek reagimi i bashkësisë pakicë, që mund të interpretohet si formë e nacionalizmit.⁷ Përkatësia (në një pjesë më të madhe) e pjestarëve të dy bashkësive më të mëdha etnike ndaj religjioneve të ndryshme, vetëm e harmonizon tendencën drejt polarizimit dhe njëfarë mospajtimit midis dy grupeve që përdoret në arenën politike si instrument për fitimin e besimit midis votuesve (të vetë) dhe mobilizimin e tyre në ciklet e ardhshme zgjedhore.

⁷ Kuper 1999 cited in Craigie , Allan, University of Edinburgh, Unionism and Pan-Nationalism: Theoretical Musings on the Dialectical Relationship between Minority and Majority Sub-State Nationalism,2010, p.232



3. Përfundim

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

Vetë pavarësimi i Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, inicoi procese në planin politik që më vonë gjeneruan kriza politike në një lloj atmosferë nacionaliste, midis të cilave kriza më e madhe kulminoi me konfliktin në vitin 2001. Pas ndryshimit të Kushtetutës në vitin 2001, kur zyrtarisht u konfirmua karakteri multi-kulturor i vendit, nacionalizmi shpesh-herë e luajti rolin e vetë në arenën politike, kurse kjo manifestoheshte edhe mbi qytetarët.

Hulumtimi, që e zbatoi grupi i pestë i shkollës verore "**Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi**", e vuri në dukje vullnetin e qytetarëve për një bashkëjetesë paqësore dhe për respektimin dhe pranimin e përbashkët të kulturave. Ajo që është pasojë e traditës dhe impaktit religjioz, është qasja konzervative ndaj dukurive të caktuara shoqërore, sikurse që është martesa midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Në lidhje me nacionalizmin, qytetarët e karakterizojnë si një dukuri negative dhe i cilësojnë partitë politike dhe ndikimin e tyre negativ si "mbrojtës" të tensioneve ndër-etnike dhe i ndajnë qytetarët, por dëshirojnë të kenë një bashkëjetesë paqësore.

Sipas të kuptuarit bashkëkohor, shtetet bashkëkohore nuk duhet të nxisin nacionalizëm tek qytetarët e vetë, por ndjenja patriotike, me ç'rast kombet bashkëkohore do të lirohen nga barra e efektit negativ nga kultivimi i nacionalizmit. Lojaliteti ndaj shtetit dhe ndjenja për përkatësinë, janë ato elemente që e bëjnë stabile komponentën multi-kulturore të shtetit. Në shtetet multi-kulturore, siç është edhe Republika e Maqedonisë, përveç promovimit të të drejtave kolektive, është e domosdoshme që të zhvillohet edhe vetëdija qytetare që do të ishte bashkuesi i diversiteteve dhe do të krijonte vlera të përbashkëta.



**SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALISMI"**

28

Bibliografia:

17 - 21 Gusht, 2015

Ohër, R. E Maqedonisë

1. Aćkoska Violeta, *Leksione nga shteti bashkëkohorë maqedonas* (1944-1990) Fakulteti Filosofik, Shkup 2011.
2. Prof. d-r Klimovski Savo, prof. d-r Karakamisheva Tanja, prof. d-r Deskoska Renata: *Sistemi politik*, Botimi i dytë, Prosvetno Delo, Shkup, 2009.
3. Popov Čedomir, *Evropa Civile (1770-1914) Historia politike e Evropës (1815-1871)* Beograd 2010.
4. D-r Spasenovski Aleksandar, *Ndikimi i bashkësive religjioze në institucionet dhe politikën e RM-së*, Fondacioni Konrad Adenauer, Shkup, shkurt 2015.
5. Craigie, Allan, University of Edinburgh, *Unionism and Pan-Nationalism: Theoretical Musings on the Dialectical Relationship between Minority and Majority Sub-State Nationalism*, 2010
6. Bakraç Vladimir "Qasje teorike ndaj ngjajshmërive dhe dallimeve midis religjonit dhe kombit", *Religjioni dhe tolerance*, 2009.
7. O'Kelly Ciaran "Nationalism and the state: Political Concepts". Manchester and New York: Manchester University Press, 2003
8. Scott, Len, *International History, 1900-90*, Oxford University Press, 2008
9. Zoran Janjetoviq. *Fëmijët e perandorëve, pastore të mbretërvë*, Minoritet nationale në Jugosllavi (1918-1945) Beograd 2005.



Fondacioni Konrad Adenauer

Projekti: „Religjioni, Përkatësia
Etnike dhe Nacionalizmi“

Risto Ravanovski br. 8
Republika e Maqedonisë
1000 Shkup

Telefon: +389 (2) 3217 075

Faks: +389 (2) 3217 076

Skopje@kas.de

www.kas.de/mazedonien/mk



Universiteti „Euro-Balkan“

Bul. Arradhat Partizane 63
1000 Shkup, Maqedoni

Telefon: +389 2 3075 570
Faks: +389 2 3090731
contact@euba.edu.mk
www.euba.edu.mk

*Qëndrimet dhe konkluzionet e dhënë në punimet janë vetëm të autorëve
dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë qëndrimet dhe konkluzionet e or-
ganizatorëve të shkollës verore.*